




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

KONSTATIME të Komitetit për Politikë dhe Financa, të rekomanduara për mbledhjen e Kuvendit të Komunës e caktuar të mbahet më 29 janar 2025

Fillimisht në kërkesë dhe propozim të drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit-DPUMM, nga 7 anëtar/e të Komitetit sa ishin prezent në mbledhje me 4 vota Për, asnjë votë Kundër dhe asnjë votë të Përmbajtur (të tjerët nuk votuan), mbështetet propozimi për përfshirjen si pikë shtesë në këtë mbledhje edhe:

- Kërkesa / Propozimi për anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1

- Propozim vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Objektivit Çerdhe Publike

Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- Draft Plani i Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban i Komunës së Podujevës për vitet 2025-2029

Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtim të kësaj pike të rendit të ditës.

- Raporti i punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës për vitin 2024

Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike të rendit të ditës.

- Raporti vjetor për vitin 2024 i Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko-Llapi” Sh.A Podujevë

Njëzëri me 7 vota Për, Kuvendit të Komunës i rekomandohet për diskutim të kësaj pike të rendit të ditës.

- Propozim vendimi për kompensimin e anëtarëve të Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale Sh.A. Podujevë; NPL Stacioni i Autobusëve, NPL për Banim, NPL Eko-Llapi (pikë nga mbledhja e kaluar e Kuvendit)

Nga 7 anëtarët e Komitetit që ishin prezent në sallë, me 3 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të përmbajtur (3 anëtar/e nuk mori pjesë në votim dhe 1 anëtar nuk mori pjesë në votim për shkak të konfliktit të interesit), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për shqyrtimin e këtij propozim vendimi sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

- **Kërkesa / Propozimi për anulimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-350/01-0050259/24 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1**

Nga 7 anëtarët e Komitetit që ishin prezent në sallë, me 5 vota Për, asnjë votë Kundër, asnjë votë të përmbajtur (2 anëtarë/e nuk mori pjesë në votim), Kuvendit të Komunës i rekomandohet për përfshirje në kuadër të rendit të ditës në mbledhjen e caktuar për datën 29.01.2025 dhe njëkohësisht shqyrtimin e kësaj Kërkese/propozimi sipas materialit përkatës të prezantuar në mbledhjen e KPF dhe bashkëngjitur këtyre konstatimeve

Nr. Prot.01-060/01-0005886/25
Podujevë, datë: 28 janar 2025



Nga: Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal - Podujevë

Kërkesë

Për futje në rend dite, për mbledhjen e datës 29.01.2025, të Kuvendit Komunal të Podujevës, pikën: “Anulimi i “Vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1””

Kronologjia e procedurës:

Kuvendi i Komunës së Podujevës me 31.07.2024 merr “Vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1”, me Nr.Prot. 01-350/01-0050259/24, dt.31.07.2024.

Me datë 07.08.2024 është parashtruar kërkesë për shqyrtim të ligjshmërisë, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL). Të njëjten kërkesë me datë 15.08.2024 MAPL e përcjellë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI).

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përmes shkresës Nr.Prot. 5262-2/244, Vlerësim i ligjshmërisë së aktit administrativ, kërkon nga Kuvendi i Komunës së Podujevës “Rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit”.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Podujevës përmes shkresës “Kërkesë” dt. 04.10.2024 kërkon nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Departamenti ligjor, përmes MAPL-së, Rivlerësim të Vendimit të lartëcekur. Të njëjtën shkresë MAPL e përcjellë në MMPHI, me dt.11.10.2024 përmes shkresë “Shkresë përcjellëse për në MMPHI”.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përmes shkresës “Vlerësim i ligjshmërisë së aktit komunal” Nr. Prot. 6559-2/24, dt.17.01.2025, kërkon nga Kuvendi Komunal i Podujevës “Rishqyrtim i ligjshmërisë së aktit”, me arsyetimin si në vijim: “Vendimi duhet të plotësohet në preambulë me nenin 5, 6, 7 dhe 8 të UA MMPHI 01/18 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme; Vendimit duhet t`i bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi për “pjesën e poshtme të qendrës 2 Lindje – Blloku 1.; Raporti i arsyeshmërisë duhet të punohet sipas nenit 6 dhe 7 të UA MMPHI 01/18.”

Bazuar në shkresën e fundit të MMPHI-së “Vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1” nuk është në harmoni me legjislacionin në fuqi, gjegjësisht është në shpërputhje me UA MMPHI 01/18 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Ky vendim për iniciim të hartimin të planit rregullues atakohet nga legjislacioni në fuqi në aspektin juridik-procedural dhe përmbajtësor, andaj, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Podujevës, kërkon nga Kuvendi i Komunës shfuqizim e “Vendim për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1”, të dt.31.07.2024 .

Me qëllim të zbatimit të legjislacionit në fuqi, në aspektin procedural dhe profesional, DPUMM propozon shfuqizimin e këtij vendimi, me qëllim të iniciimit të ri procedural, në harmoni me legjislacionin në fuqi dhe dokumentin e planifikimit hapësinor.



Liridon Gashi

Drejtör i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), 17 dhe 40 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenit 10 paragrafi 2.1 dhe nenin 17 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr.04/L-174, Udhëzimit Administrativ MMPH nr.01/2018 për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, neneve 14, 15 paragrafi 2.4; nenet 19 dhe 34 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, në propozim të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2024, miratoi këtë,

V E N D I M PËR INICIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM NË PJESËN E POSHTME TË QENDRËS 2 LINDJE - BLOKU 1

Neni 1

Me këtë vendim lejohet iniciimi i procedurave për hartimin e **Planit Rregullues të Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1"** në Komunën e Podujevës, sipas Raportit të Arsyeshmërisë i përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, bashkëngjitur këtij vendimi, Zona Kadastrale Podujevë, me sipërfaqe të përgjithshme 323631.125 m², sipas Hartës Zonale të Komunës.

Neni 2

Planet Rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave urbane apo zona rurale siç është e përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për periudhën 2016 - 2025 si dhe Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022 - 2030.

Neni 3

Bartës i procesit të hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1" është Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit si Autoritet përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor, në koordinim dhe bashkëpunim me Drejtoritë sektoriale brenda Komunës së Podujevës.

Neni 4

Plani Rregullues i Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1" do të mbulon periudhën të paktën 8 (tetë) vite

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren (QRK) nr.06/2021.

Nr.Prot.01-350/01-0050259/24
Podujevë, datë, 31.07.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Milmi Hoxha



Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration

No. 020-515/1
15.08.2024

-VI-

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Izedin Bytyqi, U.D Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI	
Kopje:	Kryetare e Komunës së Podujevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së	
Përmes:	Jeton Qela, UD. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 09.08.2024
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	Nr. 020-515
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MMPHI	
Lloji i aktit:	Vendimi i Kuvendit të Komunës	

Të nderuar Sekretar,


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin Nr. 01-350/01-0050259/24 për incimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësisshëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - Blloku 1, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3 të Rregullore (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr. 01-350/01-0050259/24 për incimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësisshëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 lindje - Blloku 1.

I miratuar më datë: 31.07.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.08.2024



Mjedesa	DL	Procedura	5262/24
Organi i shtetit		Procedura	
Numri i aktit	02	Udhë	03.09.24
Titulli		Data	
Posta			
KRISHITINE / A		Nr. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, UD. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, UD. Sekretar i Përgjithshëm i MMPHI
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	Shendrita Latifi - zyrtare ligjore në Divizionin për 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lënda:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal
Lloji i aktit:	Vendimi për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, miratuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, datë 31.07.2024

I nderuar kryetar Bulliqi,
I nderuar kryesues Hoxha

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me datë 15.08.2024 ka pranuar nga MAPL, Vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, miratuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, datë 31.07.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave kërkon nga kuvendi komunal i Podujevës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Vendimin për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, miratuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, datë 31.07.2024.

ARSYETIMI

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës pas shqyrtimit të përmbajtjes së Vendimit të lartcekur, konstatoi se:

Në Nenin 1, "... sipas Raportit të Arsyeshmërisë i përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrotjtjes së Mjedisit....sipas Hartës Zonale të Komunës";

Neni 2 "Planet rregulluese të Hollësishme përcaktojnë kushte për rregullimin e hapësirave urbane apo zona rurale siç është e përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për periudhën 2016-2025 si dhe Hartën Zonale të Komunës së Podujevës për periudhën 2022-2030".

Përshkrimi është konfuz pasi nuk është e qartë nëse Plani rregullues i hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 lindje - Blloku 1 parashihet me Dokument të Planifikimit Hapësinor ose nuk është i paraparë me Dokumentet e Planifikimit Hapësinor dhe duhet të punohet Raporti i Arsyeshmërisë duke ju referuar Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Në mënyrë që të bëjmë një vlerësim të saktë të ligjshmërisë kërkojmë që vendimit të bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi ku është i paraparë Plani Rregullues i Hollësishëm në pjesën e poshtme të Qendrës 2 lindje - Blloku 1.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve, të komunave.





Drejtoria e Administrimit të Territorit Podujevë		
Drejtoria e Administrimit të Territorit Podujevë		
Dërguar me Hollësisht 04.10.2024		
Nr. Org. Inst.	Nr. Pr.	Simbol - Prilog
01-016/01-0066844/24		
PODUJEVË - PODUJEVO		

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYESUESI I KUVENDIT

Për: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës - MMPHI
- Departamenti Ligjor

Përmes: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL
- Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave

Çështja: Kërkesë

Të nderuar/a

Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 31.07.2024 ka miratuar Vendimin nr. prot.01-350/01-0050259/24 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1" ku pjesë përbërëse e tij është edhe Raporti i Arsyeshmërisë ashtu siç thuhet edhe në nenin 1 të vendimit dhe që parashihet me legjislacionin në fuqi.

Më 06.08.2024 përmes Shkresës përcjellëse nr. prot.01-016/01-0050276/24 Komuna e Podujevës ka përcjellë në MAPL aktet e Kuvendit të Komunës nga mbledhja e mbajtur më 31.07.2024 ku është i përfshirë edhe Vendimi i lartcekur së bashku me Raportin e Arsyeshmërisë, dhe kjo për çdo rast edhe mund të verifikohet.

Më datë 03.09.2024 përmes Shkresës së MMPHI nr.5262-2/2024 na është kthyer vlerësimi i ligjshmërisë ku ndër të tjera kërkohet që: Në mënyrë që të bëjmë një vlerësim të sakt të ligjërës kërkohet që vendimit të bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi ku është i paraparë Plani Rregullues i Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 lindje – Blloku 1.

Lidhur me këtë në takimin e datës 03.10.2024 ku pjesëmarrës kanë qenë Drejtorë dhe zyrtar të Komunës së Podujevës, Zyrtarja përkatëse e MMPHI si dhe Zyrtarë të MAPL-së, sipas informatave që kam thuar përmbajtja e aktit është sqaruar dhe krejt kjo me qëllim të gjetjes së një zgjidhje sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë ngase dokumenti i cili është kërkuar t'i bashkëngjitet vendimit veçse i është bashkëngjitur me kohë dhe është dërguar në Ministri së bashku me vendimin në fjalë, pra bëhet fjalë për Raportin e Arsyeshmërisë i cili përmban të gjitha të dhënat e kërkuara.

Në këtë kontekst, konform sqarimeve dhe diskutimeve nga takimi që kishim si dhe duke pasë parasysh nenin 75.3 dhe 75.4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale, kërkohet nga MMPHI - Departamenti Ligjor të bënë ri-vlerësimin e Vendimit të lartcekur i cili ju ridërgohet sërish së bashku me Raportin e Arsyeshmërisë, në mënyrë që t'i jepet një epilog final vendimit në fjalë.

Paraprakisht ju falënderojmë për mirëkuptimin e Juaj.

Bashkëngjitur:

-Vendimi nr. prot.01-350/01-0050259/24 për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për "Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1" ku pjesë përbërëse është edhe Raporti i Arsyeshmërisë.

Podujevë,
04 tetor 2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha

1/5



REPUBLIKA E KOSOVËS
 QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministerstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration
 Nr. 020-515/35
 11.10.2024

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministerstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Izedin Bytyqi, UD Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Podujevës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
PërMMPHI:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, U.D Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 07.10.2024 Nr.020-515-1
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse		
Lënda:	Shkresë përcjellëse për në MMPHI	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,


Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Kërkesë për rishqytim të ligjshmerisë së Vendimit nr. 01-350/01-0050259/24 për incimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 Lindje- Blloku 1., miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3 të Rregullore (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Kërkesë për rishqytim të ligjshmerisë së Vendimit nr. 01-350/01-0050259/24 për incimin e procedurave për hartimin e planit rregullues të hollësishëm në pjesën e poshtme të qendrës 2 Lindje- Blloku 1.

I miratuar më datë: 12.09.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 16.09.2024



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Për:	Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës së Podujevës Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës	
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Liburn Aliu, Ministër i MMPHI Izedin Bytyqi, UD. Sekretar i Përgjithshëm në MMPHI	
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor	Nr. 167/24 Datë: 15.01.2025
Zyrtarët përgjegjës:	1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
Lënda:	Shendrita Latifi - zyrtare ligjore në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit	
Lloji i aktit:	Vlerësimi i ligjshmërisë së aktit komunal Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit për Inicimin e Procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, miratuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, datë 12.09.2024	

I nderuar kryetar Bulliqi,
I nderuar kryesues Hoxha.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, (MMPHI) në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, me datë 11.10.2024 ka pranuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) Kërkesën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit për Inicimin e Procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje - Blloku 1, miratuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, datë 12.09.2024.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së aktit në fjalë, dhe në pajtim me Nenin 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave kërkon nga kuvendi komunal i Podujevës:

RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË AKTIT

Kërkesën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit për Inicimin e Procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm në Pjesën e Poshtme të Qendrës 2 Lindje – Blloku 1, miratuar nga Kuvendi Komunal i Podujevës, datë 12.09.2024.

ARSYETIMI

MMPHI pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur konstatoi se:

Vendimi duhet të plotësohet në preambulë me nenin 5, neni 6, 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ MMPH 01/18 Për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Vendimit duhet t'i bashkëngjitet ekstrakti nga dokumenti i planifikimit hapësinor në fuqi për "pjesën e poshtme të qendrës 2 Lindje – Blloku 1"

Raporti i arsyeshmërisë duhet të punohet sipas Nenit 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH 01/18 Për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme dhe Udhëzimin Administrativ 08/2017 Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Nga ajo që u tha më lartë, të veprohet sipas vlerësimit të ligjshmërisë së aktit komunal nga MMPHI, të merret vendim i drejtë dhe i ligjshëm në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, jo më vonë se afati i paraparë në dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.